

| | |
|---|----------------------|
| REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO | |
| AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY | |
| Dep. 2-D/DPK | Nr. Prot. 01-1952/15 |
| Dep. 04 | Br. Prot. Prot No |
| Nr. i faq. | Data 14.07.2015 |
| Broj stranica | Datum |
| No. pages | Date |



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI - CORRUPTION AGENCY

| | |
|------------------------|--|
| DATË/A: | 14.07.2015 |
| REFERENC-Ë: | DPK- DPKPP-03-03/1725/15 |
| PËR/ZA/TO: | z. Elmaze XHEMA Udhëheqëse e Divizionit të Prokurimit në Ministrinë e Financave |
| CC: | z. Naim BAFTIU Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave |
| NGA/OD/FROM: | Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Opinion lidhur me Tenderin me titull " Shërbimet e krijimit të Spoteve televizive dhe dizajnimi i web faqes së Ministrisë së Financave " |

E nderuara znj. Xhema ,

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me Tenderin " Shërbimet e krijimit të Spoteve televizive dhe dizajnimi i web faqes së Ministrisë së Financave " me numër prokurimi: 201-15-030-221, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin " Shërbimet e krijimit të Spoteve televizive dhe dizajnimi i web faqes së Ministrisë së Financave " me numër prokurimi: 201-15-030-221, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 për Prokurimin Publik.

Arsyetimi

Ministria e Financave si Autoritet Kontraktues, përmes Divizionit të Prokurimit ka iniciuar procedurën e prokurimit me titull " *Shërbimet e krijimit të Spoteve televizive dhe dizajnimi i web faqes së Ministrisë së Financave " me numër prokurimi: 201-15-030-221*, e cila është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me dt.26.06.2015 dhe zgjatja e afatit për dorëzimin e ofertave e cila është bërë me dt.10.07.2015. Autoriteti Kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë Procedurën e hapur, kontratë të llojit Shërbime me vlerë të mesme. Në këtë aktivitet të prokurimit Autoriteti Kontraktues ka paraparë 2 lote (pjesë), ku në lot 1 është paraparë të bëhet Realizimi i Spoteve televizive, ndërsa në lot 2 është paraparë të bëhet dizajnimi i web faqes së Ministrisë së Financave.

Agjencia kundër Korrupsionit, sipas detyrës zyrtare ka trajtuar këtë procedurë të prokurimit ku gjatë shqyrtimit dhe ekzaminimit të dokumenteve në dispozicion për këtë tender, ka hasur në disa kërkesa të cilat janë në kundërshtim me Legjislacionin në fuqi i cili e rregullon fushën e Prokurimit Publik në Republikën e Kosovës.

Agjencia pasi ka shqyrtuar dhe analizuar me kujdes dokumentet përkatëse të kësaj procedure të prokurimit ka konstatuar shkeljet e Ligjit për Prokurimin Publik si në vijim:

Në njoftimin për kontratë i cili është publikuar në faqen elektronike të KRPP-s tek rubrika **III.2.3) Kapaciteti Teknik dhe profesional tek Llot 2 ku është paraparë dizajnimi i Ueb-Faqes është kërkuar nga Operatori ekonomik të ofrojë dëshmi se ka ose mund të angazhojë staf të mjaftueshëm për kryerjen e projektit, siq janë: tek pika a) Udhëheqësi i ekipit duhet të jetë inxhinier i diplomuar dhe të ofrojë diplomë ose dëshmi të cilat vërtetojnë përvojën e tij, tek pika b) janë kërkuar Referenca për çeb zhvillim një (3) referenca nga institucionet e Kosovës (origjinal ose kopje), tek pika c) janë kërkuar referenca për web aplikacione një referencë . Kërkesa këto për të cilat Agjencia Kundër Korrupsionit konsideron se janë diskriminuese dhe kufizojnë konkurrencën e lirë në mesin e Operatorëve ekonomik. Sipas LPP-së Autoriteti kontraktues ka të drejtë të kërkojë kontrata dhe referenca për furnizimet që ka realizuar Operatori ekonomik me Institucionet Publike, misionet ndërkombëtare dhe Institucionet Private, mirëpo nuk është e lejuar që të kërkohen kontratat dhe referencat vetëm nga Institucionet Publike, por duhet të pranohen kontratat dhe referencat edhe nga Institucionet tjera Ndërkombëtare e private me kusht që kontratat dhe referencat me Operator Ekonomik Privat të vërtetohen përmes transaksioneve. Gjithashtu nuk është e lejuar që kontratat apo referencat të kërkohen nga Operatorët ekonomik, pa u kërkuar të njëjtat në 3 vitet e fundit (2012,2013 dhe 2014). Për më tepër tek kërkesa a) ku është kërkuar Inxhinier i diplomuar nuk është theksuar se çfarë kualifikimi universitar duhet të ketë me ç rast kemi një kërkesë jo precize jo të qartë për tenderuesit.**

Tek *Dëshmia e kërkuar dokumentare* është kërkuar lista e shërbimeve duke saktësuar: shumën e kontratës, datën dhe pranuesit. Për dëshmi duhet referencat për realizimin e suksesshëm të kontratave për shërbime në fushën e planifikimit hapësinor të realizuara gjatë 3(tri) viteve të fundit. Kërkesë kjo për të cilën AKK konsideron se është tërësisht e panevojshme dhe nuk ka të bëjë fare me natyrën dhe llojin e prokurimit në fjalë. Tek **Përshkrimi i përgjithshëm i zgjedhjes teknike** tek pika 1. është kërkuar që Kompania duhet ti ketë 2 vite përvojë pune në video spote, xhirime në formatin 4K/dëshmi origjinale në DVD me punët porfolio. Ndërsa tek kërkesa 2 dhe 3 është kërkuar që OE duhet ti ketë mbi minimumin 5 fushata /spote komerciale për brenda vendit. Tek kërkesa 3. Janë kërkuar mbi 2 fushata të ngjashme. Në lidhje me kërkesën 1 dhe 3 Agjencia konsideron se është e panevojshme të vendosen kërkesa të tilla pasi që në kërkesat e caktuara më lartë të Dosjes së tenderit, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar që Operatorët ekonomik duhet të ofrojë kontrata me referenca në lidhje me shërbimet e ngjashme, andaj Autoriteti kontraktues nuk duhet të caktojë kërkesa të dyfishta. Tek kërkesa 2 ku është kërkuar që OE duhet ti ketë mbi minimumin 5 fushata /spote komerciale për brenda vendit, Agjencia konsideron se është diskriminuese dhe favorizon vetëm ata Operator ekonomik të cilët kanë realizuar spote komerciale brenda vendit dhe i përjashton Operatorët tjerë të cilët kanë realizuar spote edhe jashtë vendit.

Agjencia Kundër Korrupsionit gjithashtu ka vërejtur edhe disa shkelje tjera si në vijim: tek rubrika dëshmitë e dokumentuara për LLOT 2 është kërkuar që të jetë Kompani me e vjetër se 5 vjeçare në funksion vetëm për OE fitues. Kërkesë kjo për të cilën AKK konsideron se është kufizuese , diskriminuese dhe pengesë e panevojshme për Operatorët ekonomik të cilët janë të interesuar që të dorëzojnë tenderët e tyre.

Në rubrikën III. 1.1. tek Siguria e kërkuar e ekzekutimit, Autoriteti Kontraktues ka paraparë 10% të vlerës së planifikuar të kontratës ku është cekur se në rast se u jepet kontrata, para se ta nënshkruani kontratën ju duhet të depozitoni një siguri të ekzekutimit në vlerë prej 10 %, në formë garancie bankare të pakushtëzuar të lëshuar nga një bankë me reputacion, për një periudhë që mbulon vlefshmërinë e kohëzgjatjes së kontratës. Pavarësisht kushtit të përmendur më sipër, Siguria e ekzekutimit mund të depozitohet edhe për periudhën e vlefshmërisë për 12 muaj. Sipas Udhëzimit administrativ nr.02/2014 të miratuar nga Komisioni Rregullativ për Prokurimin Publik, Autoritetit Kontraktues nuk i lejohej që të kërkojë Sigurinë e ekzekutimit të Kontratës të lëshuar vetëm nga Bankat me Reputacion, por duhet që të ju lejojë Operatorëve ekonomik të ofrojnë Sigurinë e ekzekutimit të kontratës edhe nga Kompanitë e Sigurimeve me Reputacion, përveç Bankave në pajtim me Udhëzimin e lartpërmendur. Në rastet kur Autoriteti Kontraktues kërkon nga Operatorët ekonomik të depozitojnë sigurinë e ekzekutimit të kontratës, atëherë duhet që në pajtim me Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik të kërkojë që Sigurimi i ekzekutimit do të mbetet valid për një periudhë prej tridhjetë (30) ditë pas kompletimit të kontratës që nënkupton se në rastin konkret ku kohëzgjatja e kontratës është paraparë 12 muaj të kërkojë që siguria e ekzekutimit do të jetë valide 13 muaj .

Në pikën 21.1 tek periudha e vlefshmërisë së tenderit tek Fleta e të dhënave të Tenderit Autoriteti Kontraktues ka caktuar vlefshmërinë e tenderit në afat prej 90 ditësh. Ndërsa tek pika 13.2. tek Siguria e Tenderit Autoriteti Kontraktues ka kërkuar vlerën e sigurisë prej 1.000.00 € me afat vlefshmërie prej 90 ditësh. Sipas Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, Sigurimi i tenderit do të qëndroj valid për një periudhë prej tridhjetë (30) ditë pas skadimit të periudhës së validitetit të tenderit. Në rastin konkret Autoriteti Kontraktues do duhej që Sigurinë e Tenderit ta kërkonte në afat prej 120 ditësh.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 7 Barazia në trajtim dhe jo Diskriminimi, nenin 27 Dosja e Tenderit, nenin 63 Siguria e ekzekutimit, dhe nenin 69 Aftësia Teknike dhe Profesionale të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042 dhe nenin 4 Formulari i Sigurisë së Ekzekutimit të Udhëzimit Administrativ nr. 2/2014 të KRPP-së, nenin 26 Sigurimi i Tenderit dhe nenin 27 Siguria e Ekzekutimit të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik.

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet të lejohen në Procese të Prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsionit rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues që t'i mos i përsëris praktikat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !